



Për:	N.SH. "AL - ING" me adresë në Gjakovë
Nga:	Jetulla Kabashi - Menaxher i Prokurimit - Komuna e Rahovecit
Lënda:	VENDIM i Kërkesën për rishqyrtim të datës: 24/10/2018
Datë:	26/10/2018

I nderuar z. Xheded Morina - Drejtor,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të datës: 24/10/2018, të pranuar në formë fizike me Nr. të prot. 2898, nga Operatori Ekonomik: N.SH. "AL - ING" me adresë në Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mbikëqyrja e investimeve kapitale Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-18-5814-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-18-046-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues: (AK) - **Komuna e Rahovecit**.

Kërkesa është **REFUZUAR** si e pa bazë konform nenit 108/A pika 8.4 të LPP-së, sepse asnjë nga këto nenet nuk janë shkelur.

- Arësytim:

Pas kërkesës tuaj dhe pretendimeve se janë shkelur nenet:

Neni 1 - Qëllimi,

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pika 1,2 dhe 4,

Neni 60 - Kriteri për Dhënien e Kontratës.

Dëshmi se është respektuar LPP - ja:

Qarkullimi për tri vitet e fundit është kërkuar Dëshmia nga ATK - ja me deklaratë tatimore e jo qarkullim bankar.

Te pretendimeve tuaja se keni referenca sipas dosjes se tednerit, ju bëjmë me dije se është kërkuar vlera e referencave: 120,000.00 €, për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjajshme.

Ju në listën e prezantuar dhe referenca të dorëzuara nuk e arrin këtë vlerë, vlera e referencave tuaja është: 24,651.53 € për tre viet e fundit, dhe në bazë të LPP - së komisioni me të drejtë ju ka refuzuar ofertën tuaj si të papërgjegjshme.

I nderuar z. Xhevdet morina gjatë qasjes në dokumentacionin e Grupit të Operatorëve Ekonomik: "P.M.N." Sh.p.k. & "Al - Group" Sh.p.k. - Prishtinë, ju nuk e keni kontrolluar fare dosjen, por vetëm kemi kërkuar që kompet dosja të bëhet kopje dhe ta merrni me veti gjë që e kemi bërë këtë veprim.

E gjitha dosja e Grupit të Operatorëve Ekonomik: "P.M.N." Sh.p.k. & "Al - Group" Sh.p.k. - Prishtinë, nga vetë përfaqësuesi është e numerizuar dhe me inciale, Cerifikata EN - ISO 9001:2008, nuk mungon por është në dosjen e operatorit ekonomik dhe ka nr. 148 me inciale.

Të gjitha dokumente tjera janë të vëretuara në pjesën e pasme të fletës sipas rregullave ligjore.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

-Kundër këtij **vendimi të AK ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së.

Me respekt:
Jetulla Kabashi
Shef i Zyres se Prokurimit
Komuna e Rahovecit

